

EDITORIAL

Gjithçka është tek komunikimi...

Në prill të vitit 2006, u lanua Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (MUSPP). Ky program financohet nga Qeveria Suedeze përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillimin Ndërkombëtar, si dhe implementohet nga UN-HABITAT-i në Kosovë. Programi ofron asistencë teknike për gjashtë qytetet sekondare, për t'i ndihmuar ato në përforcimin e planifikimit strategjik dhe përfshirës. Synimi kryesor është përforcimi i kapaciteteve lokale për të ndërtuar procese të qëndrueshme të planifikimit urban, për zbatimin e masave dhe veprimeve si dhe monitorimin e zhvillimit urban. Motoja e MUSPP-it, "Bashkë Krijojmë Qytete më të Mira", mund të arrihet vetëm përmes bashkëpunimit intenziv me homologët tanë. Këto janë komunat, me qytetet sekondare të Kosovës, si dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Komunikimi dhe rrjetëzimi janë veglat thelbësore për përforcimin e kapaciteteve për urbanizimin e qëndrueshëm. Komunikimi bren-

da dhe në mes komunave, mes nivelit lokal e qendror, mes institucioneve kosovare e ndërkombëtare, mes planerëve e vendim-marrësve, si dhe edhe më me rëndësi – mes vendim-marrësve e njerëzve, bashkësisë afariste dhe organizatave të shoqërisë civile. Planifikimi pjesëmarrës arrihet me komunikim e bashkëpunim. Qeverisje e mirë do të thotë vendim-marrje e zbatim i tyre në bazë të komunikimit të vazhdueshëm dhe të respektuar mes grupeve e individëve të ndryshëm në shoqëri. E dijmë që është më lehtë të flitet se sa të bëhet. Ne vetëm shpresojmë që ky Buletin të kontribuojë në komunikimin dhe ndërveprimin e gjithë partnerëve të lidhur me MUSPP-in dhe planifikimin e qëndrueshëm hapësinor në përgjithësi. Gjithashtu, shpresojmë që jo vetëm ta lexoni këtë Buletin, por edhe të shkruani për të në numrat e tij të ardhshëm. Vërejtjet dhe kontributi juaj mirëpritur përzemërsisht.

*Ekipi i MUSPP-it,
UN-HABITAT*

- Lëvizja urbane në Kosovë - sfidë e madhe
- Përfshirja e Shoqërisë Civile në Procesin e Planifikimit
- KOSOVA, shembull i praktikave të mira ndërkombëtare
- Gjendja e tanishme e "Bërjes së qyteteve më të mira bashkë"
- UN-HABITAT-i identifikon zonat prioritare për Evropën
- Peja, qyteti i parë kosovar me PZHK/PZHU?

PILOT-PROJEKTI – AUTOBUSI URBAN NË PEJË

Sot, qyteti i Pejës nuk ka ndonjë sistem të përshtatshëm të transportit urban. Sistemi i transportit publik urban është pjesë e pashmangshme e një strukture të shëndoshë dhe ekonomike urbane. Megjithatë, themelimi i linjës së rregullt të autobusit urban nuk është punë e lehtë. Kështu, Komuna e Pejës, në bashkëpunim me UN-HABITAT-it dhe Kosovatrans-in, vendosi të fillojë një pilot-projekt, në të cilin linja e autobusit urban u testua për 5 ditë.

më shumë në faqe 4



KOSOVA BALLAFAQOHET ME SHUMË SFIDA, POR ËSHTË E VENDORUR TË NDJEKË PRAKTIKAT MË TË MIRA TË QEVERISJES SË MIRË

"Qeverisja e mirë në Kosovë ende pritet të instalohet, sepse duhet të gjejmë mënyrat për të përmirësuar administrimin dhe menaxhimin e organeve administrative; nuk mund të llogarisim vetëm në patriotizmin e njerëzve, por të gjejmë mënyrën për motivimin e tyre dhe kompensimin e punës së tyre", deklaroi Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Z. Ardian Gjini, në fjalën e tij të hyrjes gjatë Konferencës mbi Qeverisjen e Mirë, të mbajtur në Prishtinë, më 27-28 shtator 2006. Konferenca ishte organizim i përbashkët nga Zyra e Kryeministrit për Qeverisjen e Mirë, të Drejtat Njerëzore, Mundësitë e Barabarta dhe Çështjet Gjinore, UN-HABITAT-i dhe Qendra e Resurseve të Avokimit dhe Trajnimeve. Për dy ditë, ekspertë kosovarë e ndërkombëtarë, përfaqësues të organeve qendrore dhe lokale qeveritare, organizata të shoqërisë civile dhe komuniteti afarist, diskutuan një gamë të gjerë problemesh, duke nisur prej decentralizimit, kornizës ligjore e sundimit të ligjit, e deri tek pjesëmarrja e qytetarëve në vendim-marrje dhe proceset e planifikimit zhvillimor urban.

më shumë në faqe 10

LËVIZJA URBANE NË KOSOVË – SFIDË E MADHE

Planerët e transportit dhe ata urban në Kosovë ballafaqohen me sfida të mëdha. Sfidat e tilla përfshijnë sigurimin e një sistemi të shpejtë, të besueshëm dhe të sigurtë të transportit, i cili do të lidhte qytetet me të mëdha për të formuar një bashkësi përparimtare e efikase. Dhe, si të zgjidhet çështja e numrit të automjeteve në rritje të shpejtë, të cilët shkaktojnë dendje në zonat urbane, si dhe rreziqe e kërkesa të mëdha në rrjetin e rrugëve kryesore të Kosovës? A kemi trimërinë dhe largpamësinë të rezistojmë kundër përqendrimit të të gjitha përpjekjeve dhe resurseve tona

në zgjerimin e zgjatjen e rrjetit rrugor, sigurimit të kapaciteteve të mëdha veturave private, pa ndonjë zgjidhje afatgjate? Pa përpjekje të fuqishme drejt përmirësimit të gjitha formave të transportit – ecjes, biçikletave, transportit publik, e në fund edhe trafikut të veturave – problemi i lëvizshmërisë nuk do të zgjidhet kurrë. A kemi shikimin e qartë dhe vullnetin e fortë për të parë perspektivën afatgjate në probleme? A mund të shfrytëzojmë përparësitë e mundësive ekzistuese që premtojnë, dhe të cilat mund të gjenden për shembull në sektorin e transportit publik? Në disa qytete,

kemi stacione hekurudhore me lokacione të mira, dhe/ose stacione autobusi shumë afër qendrave të qytetit. A mund të ndryshojmë dëshirën aktuale për zhvendosjen e këtyre stacioneve drejt zonave periferike, dhe në vend të kësaj, të shfrytëzojmë përparësinë e krijimit të "qendrave të mobilitetit", të cilat mund të funksionojnë si injeksion ndaj zhvillimit ekonomik e komercial në qytet? Kjo është sfidë urgjente! A është Kosova e gatshme për këtë?

Gunnar Lagerqvist,
Ekspert Transporti, UN-HABITAT

KËNDI I KOMUNAVE

QENDRA E MOBILITETIT NË FERIZAJ?

Si pjesë e Takimit Shqyrtues Tre-Palësh, pas gjashtë muajve të parë të Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal, delegacioni i përfaqësuesve të Qeverisë Suedeze (Sida) dhe UN-HABITAT-it (Selia në Najrobi dhe ekipi në Kosovë), vizituan Komunën e Ferizajt më 5 tetor. Në Ferizaj, Kryetari i Komunës dhe Kryeshefi Ekzekutiv u takuan me Delegacionin. Diskutimi me Kryetarin u përqendrua në mungesën e hapësirës për aktivitete të reja ekonomike, si dhe nevojën urgjente për planet zhvillimore komunale e urbane. Sfidat është hartimi i një plani zhvillimor në kohën më të shkurtër të mundshme, me përfshirjen e pjesëmarrësve dhe shoqërisë civile.

Në pjesën e dytë të takimit, një planer i komunës paraqiti gjendjen e tanishme të Projektit të Qendrës së Mobilitetit në Ferizaj. Qendra e Lëvizshmërisë është iniciativë e përbashkët e komunës me UN-HABITAT-in, me synimin e përbashkët të qytetit me hekurudhën, e cila tani shihet si pengesë. Duke përmirësuar stacionin hekurudhor deri në nivelin e një qendre multi-modale, në kombinim me stacionin e ri të autobusëve, Qendra e Lëvizshmërisë do të kontribuonte në rigjenerimin e gjithë



qendrës së qytetit. Qendra gjithashtu do të shërbente si qendër informimi e shërbimi për qytetarët, vizitorët dhe turistët, duke qenë njëkohësisht qendër komerciale. Ajo duhet disenjuar në mënyrë që të lidhë dy anët e qytetit, tani të ndara me hekurudhë. Më 27 korrik, Kuvendi i Komunës vendosi të fillojë debatin publik mes qytetarëve e pjesëmarrësve, në bashkëpunim me UN-HABITAT-in. Nga 20-

23 nëntor, një delegacion i Komunës dhe UN-HABITAT-it do të vizitojë Qendrën e Lëvizshmërisë në Lundt, Suedi, ndërsa një nga stacionet televizive të Kosovës do të jetë aty që të xhirojë një film dokumentar për të. Delegacioni i Takimit Shqyrtues u impresionuar nga iniciativa dhe shprehën shpresën e tyre që rasti i Ferizajt do të jetë i suksesshëm dhe shembullor për qytetet tjera kosovare.

ÇËSHJTJA E LËVIZSHMËRISË NË KOMUNËN E GJAKOVËS

Më 20 tetor, u mbajt një punëtori për komunën e Gjakovës në lidhje me çështjen e lëvizshmërisë. Synimi i punëtorisë ishte që të kontribuohet në projekt Planin Zhvillimor Komunal (PZH) dhe projekt Planin Zhvillimor Urban (PZHU), që është në përgatitje nga kompania INTECH si dhe për përmirësimin e përmbajtjes së tij me planifikimin e lëvizshmërisë.

Pjesëmarrësit kryesorë, përfshirë planerët komunalë, Drejtori i Departamentit të Transportit Publik në komunë, përfaqësues të Ministrisë së Transportit, Ministrisë së Mjedisit e Planifikimit Hapësinor, UN-HABITAT-it e INTECH-ut, morën pjesë në punëtori. Në fillim, u dha një pasqyrë e gjendjes ekzistuese dhe propozimet e së ardhmes nga UN-HABITAT-i e INTECH-u. INTECH ka propozuar një rrugë tranzitore në pjesën lindore të qytetit dhe lidhjen hekurudhore prej linjës ekzistuese Pejë-Prizren.

Drejtori i Drejtorisë së Transportit Publik të Komunës së Gjakovës dha një pasqyrë të planit të sigurimit të shiritave për ciklistë në tri rrugët kryesore. Ai gjithashtu përmendi që qytetin e vjetër është vështirë ta lidhin me sistemin e transportit publik. Eksperti i planifikimit të transportit në UN-



HABITAT, Z. Gunnar Lagerqvist, shpjegoi nevojën dhe karakteristikat e një sistemi të mirë të transportit publik, si dhe që Projekt PZH/PZHU nuk ka atë sistem. Ai shpjegoi që Gjakova është tani qytet linear, dhe ekziston nevoja e diskutimit nëse ka nevojë të transformohet në qytet radial (rrethor) në të ardhmen. Ai gjithashtu propozoi që të transformohet linja një-drejtimëshe e autobusit në linjë dy-drejtimëshe. Ai propozoi krijimin e qendrës së mobilitetit në lokacionin e ish kazermës afër, e cila do të përmbante stacionin e au-

tobusëve, stacionit të trenit, parkimin e biçikletave, si dhe nevojën e rezervimit të kësaj hapësire qysh tani. Planerët nga Drejtoria Komunale e Urbanizmit përmendën propozimin e qarkores në anën perëndimore të qytetit, përgjatë kodrës së Çabratit, si dhe mundësinë e sistemit të transportit ujor.

Përfundimi u mor që të mbahen takime tjera me shfrytëzues e pjesëmarrës, duke përgatitur grupin e veçantë dhe planin e veçantë të punës mbi çështjen e transportit.

PLANIFIKIMI I GJILANIT

Komuna e Gjilanit është në proces të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZH) dhe Planit Zhvillimor Urban (PZHU). Duke pasur parasysh që ky është proces multi-sektoral, janë formuar pesë grupe tematike:

1. Demografia dhe Mirëqenia Sociale
2. Shfrytëzimi i Tokës dhe Mjedisit
3. Infrastruktura
4. Zhvillimi ekonomik
5. Sinergjia

Gjithashtu, ekzistojnë disa grupe jo-formale të përfshira në procesin e planifikimit: një grup qytetarësh nga zonat urbane dhe rurale, një grup i sektorit privat, një grup OJQ-sh, si dhe një grup qytetarësh minoritarë.

Me komentet e tyre, projekt-propozimet dhe sugjerimet në lidhje me çështjet e planifikimit hapësinor dhe urban, grupet kanë kontribuar në përgatitjen e raporteve sektorale. Duke synuar një proces përfshirës dhe pjesëmarrës të planifikimit, Komuna ka mbajtur më shumë se 80 takime me pjesëmarrës të ndryshëm, duke diskutuar çështjet e planifikimit, si transporti e shtratin e lumit. Një punëtori e vizionimit pritet të organizohet nga komuna si pjesë e procesit të planifikimit. Planet ekzistuese rregullative (si ai për lumin Mirusha dhe Livoqin e Ulët) do të inkorporohen në PZH dhe PZHU.

Duke iu falënderuar bashkëpun-

imit me UN-HABITAT-in dhe Institutin për Planifikim Hapësinor, është krijuar baza e shënimeve me GIS, pas një trajnimi një-ditor të ofruar nga UN-HABITAT-i. Komunikimi dhe bashkëpunimi i mirë brenda Drejtorive komunale dhe Ministrisë, sidomos me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duhet të nënvizohet në këtë drejtim. Gjithashtu, duhet të lëvdohet mbështetja e UN-HABITAT-it gjatë gjithë procesit të planifikimit.

Pjesë nga fjalimi i Fadil Sherifit (ushtrues detyre i Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Urbanizmit në Gjilan) në konferencën e Qeverisjes së Mirë Urbane, Prishtinë, 04/10/06

MITROVICA KA NEVOJË PËR PLANIFIKIM TË LËVIZJES

Në Komunën e Mitrovicës, mbështetja nga UN-HABITAT-i është përqendruar në ndihmën për planerët në jug e veri në përzgjedhjen dhe diskutimin e çështjeve të planifikimit hapësinor me rëndësi strategjike. Në këtë kuptim, grupet tematike të punës mbi Mobilitetin dhe Transportit janë themeluar në dyja anët e qytetit, duke përfshirë planerë e zyrtarë ko-

munalë që merren me çështjet e komunikacionit, përfaqësues të Njësisë së Trafikut nga Shërbimi Policor i Kosovës, si dhe pjesëmarrës tjerë si Hekurudhat e Kosovës, Ndërmarrja Publike e Transportit, dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Takimi i parë i mbajtur me këto grupe vërtetoi edhe një herë nevojën e madhe për veprim në këtë fushë. Kështu, aktivitetet

e UN-HABITAT-it do të orientohen në ndihmën ndaj grupeve në ndërtimin e vizionit koherent të lëvizshmërisë në qytet, si dhe përzgjedhjen e projekteve strategjike për zhvillim e implementim. Nëse puna e ardhme e grupeve punuese do të rezultojë në pika të interesit të përbashkët në gjithë qytetin, UN-HABITAT-i do të mundësojë takimet e përbashkëta.

PROJEKTI EKOLOGJIK DHE "NDËRTIMI I KOMUNITETIT NË MITROVICË"

Përfshirja e qytetarëve në procesin e vendim-marrjes dhe ndërtimit të pajtimit mbi çështjet e zhvillimit lokal (parim kryesor i qeverisjes së mirë) mund të arrihen vetëm përmes bashkëpunimit të afërt të organizatave të shoqërisë civile. Me përvojën e tyre në zhvillimin e projekteve të ndryshme që kanë të bëjnë me gratë, rininë, kulturën, mediat, etj., si dhe përafërimin e gjitha komuniteteve, "Ndërtimi i Komunitetit në Mitrovicë (Community Building Mitrovica) – CBM, është bërë një nga partnerët e aktiviteteve të UN-HABITAT-it në Mitrovicë. Së bashku me tri organizata tjera të

shoqërisë civile, nga jugu e veriu, CBM do të bashkë-organizojë punëtorinë e vizionimit për përmirësimin e cilësisë së mjedisit jetësor në Mitrovicë.

Projektet e CBM-së trajtojnë nevojat direkte të komuniteteve lokale. Një nga çështjet e trajtuara nga CBM, përveç shumë tjerash, është rëndësia e Ekologjisë. Ekologjia konsiderohet të jetë një nga temat kryesore të zhvillimit lokal sipas vizionit të CBM-së. Përmes projektit, CBM provon të ngrisë vetëdijen "ekologjike" të qytetarëve të Mitrovicës nga të dyja anët e Ibrit. Deri më sot, në pranverë të 2006-ës, si

pjesë e projektit ekologjik, janë vënë 100 kosha plehrash në rrugët e veriut të Mitrovicës, si dhe rreth 50 tjera janë shpërndarë në shkollat e jugut.

Mes aktiviteteve tjera, është mbajtur edhe një ekspozitë fëminore me temë ekologjinë. Vizatimet më të mira janë marrë për broshurat me informata e shënime ekologjike. Si veprim përfundimtar, janë shfaqur shfaqje teatrale me përqendrim ekologjik në të dyja anët e Mitrovicës.

Milan Branovic, Ndihmës Projekti e Zyre, Community Building Mitrovica

PILOT-PROJEKTI – AUTOBUSI URBAN NË PEJË

Vazhdon

Gjatë periudhës së testimit, udhëtimi me autobus ka qenë i lirë, derisa operatorët monitoronin shfrytëzimin e përgjithshëm të këtij shërbimi.

Para ndërmarrjes së pilot-projektit, u ndërmor një fushatë e duhur informimi, duke përfshirë posterët dhe broshurat me hartën e linjës publike. Ato u shpërndanë tek grupet e synuara për t'i informuar për shfrytëzimin e autobusit, përfshirë grupet shkollore. Operimi i autobusit urban është një nga veprimet e propozuara me Planin Zhvillimor Urban për qytetin e Pejës. Plani skicon zhvillimet e ardhme hapësinore të qytetit, si dhe thekson marrëdhënien mes zhvil-

limit urban dhe transportit të qendrueshëm, duke përfshirë transportin publik. Kur duket që ka kërkesë dhe autobusi urban mund të kontribuojë në cilësinë e jetës së qendrës së qytetit, Komuna do të themelojë linjën e rregullt urbane, do të operojë atë, si dhe do të vendosë një tarifë të arsyeshme për udhëtarët.

Ekipi komunal i UN-HABITAT-it ka ofruar rekomandimet në vijim për veprime të ardhme, duke përfshirë:

- Kuvendi Komunal mund të emërojë një anëtar personeli (që është i punësuar tashmë) që të jetë në krye të transportit publik urban. Ky punëtor duhet të bëjë licensimin dhe kontrollimin e standardeve të cilësisë.

- Kuvendi Komunal duhet të përgatisë dhe publikojë tenderin, si dhe të lëshojë licensat për kompanitë që dëshirojnë të ofrojnë këtë shërbim rregullisht.

- Hulmtimi i mundësive për vendosjen e shenjave dhe strehëve për autobusë në rrugë. Reklamata private do të mund të financonin këto shenja.

- Një marrëveshje mes Kuvendit të Komunës dhe Policisë së Trafikut, për të kufizuar lëvizjen e kombibusëve përgjatë linjave urbane të autobusit.

Shpresojmë që së shpejti të jemi në gjendje t'ju informojmë mbi linjën urbane të rregullt në qytetin e Pejës.

“PËRFSHIRJA E SHOQËRISË CIVILE NË PROCESET E PLANIFIKIMIT ZHVILLIMOR KOMUNAL” – TRYEZË E RRUMBULLAKËT NË PRIZREN

Ekipet e UN-HABITAT-it dhe OSBE-së në Prizren mbajtën diskutimin në Tryezën e Rrumbullakët mbi “Përfshirjen e Shoqërisë Civile në Proceset e Planifikimit Zhvillimor Komunal”.

Qëllimi i kësaj Tryeze ishte njoftimi i qasjes pjesëmarrëse të planifikimit, duke sjellur së bashku organizatat e ndryshme të shoqërisë civile për të diskutuar angazhimin civil në çështjet e zhvillimit. Mëtej, shërbeu për të paraqitur konceptin e aspekteve gjinore në planifikim, për të diskutuar angazhimin e shoqërisë civile në trajtimin e zhvillimit ekonomik dhe diskutimin e transportit/mobilitetit nga perspektiva e qasjes së barabartë për mashkuj e femra, të paaftësuarit dhe grupet e ndjeshme.

Pas prezenteve nga Znj. Krystyna Galezia dhe Z. Gunnar Lagerqvist, pjesëmarrësit diskutuan temat e Ekonomisë/Punësimit dhe Mobilitetit/Infrastrukturës.

Synimet kryesore të infrastrukturës/mobilitetit, sipas grupit punues, janë: infrastrukturë më e mirë rrugore në zonat rurale, zhvillimi i transportit, mbrojtja e mjedisit, rrjetet e përmirësuar të shërbimeve shëndetësore, dhe kushte më të mira për këmbësorë,



çiklistë e njerëz me paaftësi. Vërejtje u dhanë për nevojën e ofrimit të qasjes për njerëz me aftësi të kufizuara ndaj hapësirave publike dhe që transporti publik nuk është i kënaqshëm.

Problemet në lidhje me ekonominë dhe punësimin lokal, sipas grupit të punës, përfshijnë: mungesën e legjis-

lacionit, praktika të padrejta afariste, mungesa e fondeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe doganat/tatimet e larta. Një mundësi për rritjen e të hyrave për amvisëri mund të vijë nga përfshirja e femrave në vendim-marrje, deklaroi grupi i punës për ekonomi/punësim.

KËNDI I UN - HABITAT-IT

JEHONA NGA FORUMI URBAN BOTËROR I UN-HABITAT-it NË VANKUVER

Me një delegacion prej 10 pjesëmarrësish nga UN-HABITAT-i dhe Ministria e Mjedisit e Planifikimit Hapësinor, Kosova u përfaqësua mjaft mirë në Forumin e tretë Botëror Urban në Vankuver, edhe pse ishte mjaft vështirë ta gjenim njëri-tjetrin mes 9990 pjesëmarrësve tjerë. Forumi është mbajtur më 19-23 qershor, në Vankuver, Kanada, në vendin e njëjtë ku 30 vite më parë është mbajtur Forumi i parë i UN-HABITAT-it. Është e pamundur të paraqiten gjitha konkludimet zyrtare këty. Ato mund të gjenen në faqen e UN-HABITAT-it (www.unhabitat.org/wuf), pjesën “Events”. Në vend të paraqitjes së tyre, ne kemi vendosur t’ju paraqesim 10 zëra më “provokativë” që kanë lidhje me praktikën e planifikimit në Kosovë, si dhe në veçanti me 6 qytetet sekondare:

1. Master planet janë definitivisht jashtë tani, derisa planifikimit përfshirës është evident në gjithë botën.
2. Planifikimi përfshirës nënkupton përfshirjen e GJITHË pjesëmarrësve, me theks në të varfërit dhe njerëzit e ndjeshëm në komunitete.
3. Planifikimi i orientuar drejt komunitetit nuk duhet të jetë burokratik, por i orientuar drejt terrenit dhe veprimeve. Veprimet duhen vendosur brenda një vizioni afatgjatë.
4. proceset e ngadalshme të planifikimit formal duhen zëvendësuar apo kombinuar me veprime të shpejta planifikimi.
5. Planifikimi formal duhet kombinuar me rregullime joformale.
6. Mungesa e parave, kuadrove apo të dhënave nuk është arsye për të

mos bërë asgjë, apo për t’u ngadalësuar.

7. Qytetet e qëndrueshme krijohen me veprime të qëndrueshme inkrementale.
8. qytetet ndër-kulturore krijohen me përfshirjen e gjitha grupeve kulturore.
9. Duhet siguruar lidhjet efektive mes planifikimit dhe proceseve private e publike të buxhetimit.
10. Planifikimi duhet bërë me mençuri, duke krijuar rrjete mësimi dhe shkëmbimi.

Forum i ardhshëm Botëror Urban do të mbahet në Nanjing, Kinë, më 2008. Kjo duhet të jetë mundësi e shkëlqyeshme për paraqitjen dhe diskutimin e përparimit me planifikim strategjik dhe pjesëmarrës në Kosovë.

DITA BOTËRORE E HABITAT-IT

Kombet e Bashkuara kanë caktuar të hënën e parë të Tetorit të çdo viti që të jetë Dita Botërore e Habitat-it, për të menduar mbi gjendjen e vendbanimeve njerëzore, si dhe të drejtën themelore për strehim adekuat për të gjithë. Kjo ditë mëton t'i përkujtojë botës përgjegjësinë e saj kolektive për të ardhmen e habitatit njerëzor. Qytetet, magnetet shprese ishte tema e Ditës Botërore të Habitat-it këtë vit, të hënën më 2 tetor 2006. Qytetet janë magnetet shprese për punësim dhe kushte më të mira jetese. Njëkohësisht, qytetet janë magnetet problemesh, sidomos kur nuk janë të përgatitur për një urbanizim të tillë rapid.

Me ringjalljen e përditshme të Kosovës nga lufta, shënimi i Ditës Botërore të Habitatit marrin rëndësi specifike, me fokusin e këtij viti mbi rininë, si dhe rolin e tyre kryesor që ata kanë në riformësimin e qyteteve të tyre.

Programi i UN-HABITAT-it në Kosovë, me mbështetjen e Qeverisë Suedeze, po ndihmon gjashtë qytetet sekondare në Kosovë, me planifikim urban që përfshin publikun dhe gjithë pjesëmarrësit. Shënimi i Ditës Botërore të Habitatit 2006 u përqendrua në shpërndarjen e porosisë së gjithëpërfshirjes, decentralizimit, si dhe rolin që rinia mund të marrë në formësimin e së ardhmes së saj. Në Komunën e Ferizajt, u mbajt një takim i veçantë me ekipin komunal të planifikimit dhe Bordin e Drejtorëve,

në të cilët u lexua porosia e Znj. Anna Tibajuka, Nën-Sekretare e Kombeve të Bashkuara, dhe Drejtoreshë Ekzekutive e UN-HABITAT-it. Problemet si zvogëlimi i fluksit të njerëzve drejt qyteteve dhe qytezave, mungesa e politikave dhe bashkëndimi në nivelet qendrore e komunale për zhvillim e menaxhim më të mirë urban, u ngritën. Zyrtarët e Ferizajt thanë që porosia e saj mbi qytetet përfshirëse dhe ndërtimit të urave ka rëndësi specifike për Kosovën.

Në Komunën e Gjilanit, festimi i Ditës Botërore të Habitat-it u shënuar me një garë vizatimi për fëmijët e shkollave lokale me temë Ditën Botërore të Habitat-it, "Qytetet, Magnetet Shprese". Juria e përbërë nga UN-HABITAT-i dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zgjodhi tri pikturat më të mira nga nxënësit e Shkollës Fillore Thimi Mitko, dhe pastaj bashkoi fëmijët në një debat mbi vështrimin e tyre mbi qytetin. Fëmijët e thanë qartë që kërkojnë rregull në qytet, sipërfaqe më të gjelbra, një kopsht zoologjik, dhe vendlojë.

Në Pejë, fëmijët e shkollave lokale morën pjesë në një punëtori të vërtetë, e cila trajtonte çështjet praktike, si zhvillimin hapësinor të shkollave të tyre, problemet e transportit lokal, si dhe problemet në lidhje me mjedisin në shkolla. Nxënësit u ndanë në katër grupe dhe patën mundësi të punojnë me materiale vizatimi dhe fotografi ajrore të shkollës.¹



¹ Artikull me ilustrime (fotografi) mbi këto ngjarje u publikua edhe në faqen e internetit të UN-HABITAT-it: www.unhabitat.org

GJENDJA E TANISHME E "BËRJES SË QYTETEVE MË TË MIRA BASHKË"

Më 18 korrik, përfaqësuesit komunalë të Gjakovës, Pejës, Gjilanit, Ferizajt dhe Prizrenit, u mbledhën në Hotelin Grand në Prishtinë, për të diskutuar zbatimin e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në komunat partnere. Anne-Sofie Nilsson, Udhëheqëse e Zyrës Ndërlidhëse Suedeze, si dhe Ilir Morina, Kryeshf Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (duke përfaqësuar Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) paraqitën fjalët mikpritëse. Departamenti dhe Instituti i Planifikimit Hapësinor gjithashtu ishin të përfaqësuar. Ta-


kimi për Zhvillimin e Programit ishte mundësia e parë qysh prej Takimit të Fillimit, më 6 prill, për diskutimin e çështjeve që kanë vendosur gurtëmelin e veprimtarisë së Programit. Gjithashtu, u ofrua një mundësi për diskutimin e gjendjes së tanishme të aktiviteteve në planifikim, duke përfshirë temat si:

- Themelimi i njësive Komunale të Planifikimit: roli, përbërja dhe pozita e tyre brenda strukturës së Komunave,
- Buxheti për ndërmarrjen e procesit të planifikimit në mënyrë pjesëmarrëse, duke përfshirë

konsultimet publike dhe zbatimin e planeve të veprimit;

- Tenderimi i proceseve të planifikimit tek kompanitë konsulente; pronësia komunale mbi produktin, si dhe procesi e bashkëpunimi me ekipet e UN-HABITAT-t; si dhe
- Bashkëpunimi mes komunave dhe mes komunave e nivelit qendror.

Partnerët shprehën dëshirën e tyre që të mbahen takime të ngjashme për rrjetëzim dhe shkëmbim të përvojave e informatave, të mbahen rregullisht, dhe kjo do të shqyrtohet për t'u realizuar.



PEJA, QYTETI I PARË KOSOVAR ME PZHK/PZHU?

Si pjesë e Takimit Shqyrtues Tre-Palësh më 4 e 5 tetor, një delegacion i përfaqësuesve të Qeverisë Suedeze (Sida) dhe UN-HABITAT-it, vizituan Pejën. Delegacioni u prit nga Zëvendës-Kryetari i Kuvendit të Komunës dhe Drejtori i Planifikimit Urban dhe Rural dhe Mjedisit. Gjithashtu, ishin prezentë edhe Kryetari i këshillit të Ekspertëve të Plani-

fikimit, si dhe përfaqësues të agjencive ndërkombëtare në Pejë. Zotimi është bërë që të arrihet miratimi përfundimtar i Planeve Zhvillimore Komunale e Urbane deri në fund të këtij viti. Kjo do ta vinte Pejën në pozitë udhëheqëse në planifikim hapësinor me PZHK/PZHU të miratuar, siç kërkohet me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor. Delegacioni Tre-Palësh jo

vetëm që u impresionua me procesin, por edhe me vullnetin për iniciimin – së bashku me UN-HABITAT-in – të projekteve konkrete të veprimit, si Pilot-Projekti i Autobusit Urban dhe Projekti i Portave të Qytetit. Delegacioni Tre-Palësh shprehu shpresën e tij që Autobusi Urban do të operohet shumë shpejtë, dhe të jetë shembull për qytetet tjera kosovare.

SHOQËRIA CIVILE PARTNERE E RËNDËSISHME PËR KOMBET E BASHKUARA, THOTË KOFI ANNAN

Zyra e UN-HABITAT-it në Kosovë u përfaqësua mes 3,000 përfaqësuesve të organizatave joqeveritare, agjencive të Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësuesve qeveritarë nga 90 vende, të mbledhur në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, në Konferencën e 59-të Vjetore DPI/NGO, e cila u fokusua në Synimet Zhvillimore të Mileniumit.

Konferenca theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të shumë pjesëmarrësve dhe ndërtimit të urave mes OJQ-ve dhe Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu, ajo theksoi që partneriteti dhe bashkëpunimi global mes qeverive, OJQ-ve dhe aktorëve të shoqërisë civile janë faktor kryesor në përmbushjen e Synimeve Zhvillimore të Mileniumit. Përkushtimi ndaj përgjegjshmërisë, transparencës dhe qeverisjes së mirë ishin qendër e diskutimit. Varfëria dhe uria ishin në ballin e diskutimit të grupeve të fokusit. U ndje që shkaqet e varfërisë dhe pasojat e saj shkojnë shumë më larg se mungesa e



Sekretari i Përgjithshëm, Kofi Annan:

“Duhet të ndajmë njohurinë tonë dhe të përforcojmë veprimet tona”

parave dhe përfshijnë zgjedhjen e kufizuar të kushteve të jetës e punës, dhe mundësi të pakta për arsim, gjë që çon drejt përjashtimit social.

Koncentrimi në zhvillimin e rinisë dhe sigurimin e arsimit të tyre me mbështetje financiare nga vendet e zhvilluara, ishin

mundësitë e paraqitura drejt përmirësimit të së ardhmes së shoqërive të varfra. Veçmas, është me rëndësi të përfshihen qytetarët në negociimin e kontributit të rritur të qeverive individuale të vendeve drejt përmbushjes së Synimeve Zhvillimore të Mileniumit deri më 2015.

TAKIMI SHQYRTUES TRE-PALËSH MBI PROGRAMIN M_USPP

Në ditën e katërt të Nëntorit në Prishtinë, UN-HABITAT-i, Qeveria Suedeze dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbajtën takimin Shqyrtues Tre-Palësh mbi Programin e Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor në Kosovë.

Elisabeth Belpaire, Krye-Këshilltarja Teknike e UN-HABITAT-it në Kosovë, si dhe përfaqësuesit komunalë, raportuan mbi përparimin e programit, si dhe sfidat që ata kanë në proceset e planifikimit. Homologët nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Merxhan Avdyli, Zëvendës Ministër si dhe Anne-Sofie Nilson, Udhëheqëse e Zyrës Ndërlidhëse të Suedisë në Kosovë, u njohën me punën e bërë nga UN-HABITAT-i.

Duke folur mbi zhvillimet aktuale dhe prioritetet e politikave për zonat post-konfliktuale dhe në tranzicion, Dan Luis, Shef i Degës së Sigurisë, Katastrofave dhe Post-Konfliktit në Selinë Qendrore të UN-HABITAT-it, deklaroi që mësimet e nxjerra në Kosovë, si ato në programet e menaxhimit urban dhe kadastral, kanë pasur ndikim në programet në pjesë të ndryshme të botës.

Pastaj, u vazhdua me një diskutim mbi çështjet kryesore, me komente e propozime nga forumi. Kjo ngriti disa pika interesante për diskutim të mëtutjeshëm, si dhe shqyrtim, për shembull nevoja për përforcimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit brenda sektorit, mes nivelit qendror e



komunal, si çështje në të cilën mund të ndërhyjë dhe ndihmojë edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. U theksua edhe bashkëpunimi mes komunave në hartimin e planeve të përbashkëta zhvillimore komunale, si dhe sigurimi i shërbimeve urbane, si dhe kërkimi i mënyrave në të cilat programi mund të shërbejë për të ndihmuar komunat e vogla dhe në avancimin e aftësive të kuadrove. Ekziston nevoja për projekte të prekshme, duke kombinuar veprimet dhe vizionin afatgjatë. Rëndësia e transportit brenda planifi-

kimit hapësinor komunal duhet të njihet, duke u fokusuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të transportit. Kështu, ka nevojë për më shumë fonde për pilot-projekte dhe projekte demonstrative, aty ku komunat dhe aktorë tjerë mund të ndajnë shpenzimet. Gjithashtu, u theksua që proceset politike të decentralizimit, si dhe negociatat për status, mund të kenë ndikim në zhvillimet e ardhshme të planifikimit hapësinor, si dhe të kërkojnë një shqyrtim të aktiviteteve.

UN-HABITAT-I IDENTIFIKON ZONAT PRIORITARE PËR EVROPËN

Znj. Inga Björk-Klevby, Nën-Drejtoreshë Ekzekutive e UN-HABITAT-it zbuloi pesë zonat prioritare në të cilat Agjencia do të përqendrohet në aktivitetet e saj rajonale në Evropë. Derisa ndiqte takimin e nivelit të lartë të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Komitetin e Evropës mbi Menaxhimin e Banimit dhe Tokës, më 19 shtator 2006 në Gjenevë, Znj. Björk-Klevby gjithashtu theksoi nevojën për avancimin e mëtejshëm të partneritetit të UN-HABITAT-it me UNECE, Paktin

e Stabilitetit dhe organizatat tjera rajonale, duke përfshirë Bankat Zhvillimore. Duke mbështetur Rezolutat e Këshillit Qeverisës të UN-HABITAT-it për rritjen e aktiviteteve në vendet me Ekonomi në Tranzicion, Znj. Björk-Klevby konfirmoi përforcimin e kapacitetit të UN-HABITAT-it në Evropë, përmes zyrës në Gjenevë, si dhe zyrës së sapo themeluar në Varshavë.

Znj. Björk-Klevby deklaroi që UN-HABITAT-i do të fokusojë aktivitetet e tij rajonale në Evropë në pesë zona

prioritare, gjegjësisht: Zhvillimi Rajonal i Rrjetit Global të Veglave të Tokës (GLTN); Programi Rajonal i Përforcimit të Kapaciteteve (RCSP) për Zhvillimin Urban dhe Banimin në Evropën Juglindore (EJL); Strategjitë Zhvillimore të Qyteteve; Kornizat e Politikave dhe Operacioneve për Banimin Social me Qira; si dhe Përmirësimin e Vendbanimeve joformale, duke përfshirë vendbanimet e romëve.

www.unhabitat.org/print.asp?cid=3793&catid=5&typeid=6

KËNDI I MEDIAVE

Në këndin e Mediave kemi zgjedhur disa tituj e citime interesante në lidhje me planifikimin urban dhe zhvillimet në Kosovë. Artikujt origjinal mund t'ju dërgohen sipas kërkesës.

KOSOVA, shembull i praktikave të mira ndërkombëtare

Ky artikull jep informata mbi Konferencën e Parë Rajonale të Qeverisjes së Mirë Urbane të mbajtur në Prishtinë. "Kosova është shembull i praktikave të mirë ndërkombëtare, përkundër faktit që ka pasur përparim të vogël në luftimin e varfërisë", deklaroi Drejtori i Zyrës Ndërlidhëse të UN-HABITAT-it në Bruksel, Paul Taylor.

Burimi: Koha Ditore, 28/09/2006

FERIZAJ:

"Draft Plani Hapësinor i Ferizajt" i kompletuar deri në fund të vitit

Drejtorati i Urbanizmit, grupi i ekspertëve dhe përfaqësues të kompanisë "InTech" kanë intensifikuar së voni takimet me qytetarë, për të diskutuar Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Planin Zhvillimor Urban (PZHU). Draft PZHK dhe PZHU për Komunën e Ferizajt priten të prezen-tohen para Kuvendit të Komunës në fund të këtij viti, ose fillim të vitit të ardhshëm.

Burimi: Infopress, 18/09/06 fq. 21

Koha matej me fishkëllima treni

Komente e fakte mbi përfitimet dhe pengesat e hekurudhës së Ferizajt janë dhënë me këtë artikull. Çështja e hekurudhës është sfidë e madhe për qytetarët e Ferizajt, duke u bërë tanimë pjesë e bisedave të qytetit.

Burimi: Koha Ditore 10/10/06

PRIZREN:

Lagjet e reja gjëlltisn fondet publike

Depopullimi i disa fshatrave, si dhe migrimet nga fshati drejt zonave periferike janë çështje që ngrihen me këtë artikull. Mëtej, thuhet që zonat periferike dhe lagjet e reja, e jo qendra e qytetit, janë ato zona që gjëlltisn fondet më të mëdha të komunës. Investimet në zonat rurale, sidomos në infrastrukturën rrugore dhe furnizimin me ujë ndihmojnë në zvogëlimin e tendencave migruese.

Burimi: Lajm exclusive, 03/10/06, pg.6

"Kalaja e Vashës"- atraktive për vizitorë

Ky artikull thekson vështrime interesante mbi një kala historike në Prizren, e cila ka potencial të mirë të zhvillimit ekonomik përmes turizmit.

Burimi: Koha Ditore 11/10/06

Vetëm rrokaqiejt mund të shpëtojnë Prizrenin

Ky artikull na jep mendime të ndryshme të disa profesionistëve të Prizrenit në lidhje me ndërtimtarinë banesore dhe komerciale. Ka mendime që ndërtimi i rrokaqiejve është i vetmi që mund të shpëtojë qytetin nga nja zvogëlim kaotik i hapësirave të lira. Në anën tjetër, përfaqësuesit komunalë arsyetojnë kufizimin e lartësisë së ndërtimit si kontribut ndaj mbrojtjes së zonave kulturore dhe historike.

Burimi: Lajm Exclusive, 10/10/06

MITROVICA

Ja një qytet pa kiosqe

Ky artikull flet mbi arritjet e Komunës së Mitrovicës në lidhje me qeverisjen. Arritjet përfshijnë: rritjen e të ardhurave lokale, stabilitetit të buxhetit, efikasitetin e rritur të shërbimeve publike, heqjen e kiosqeve nga trotuarët dhe pamja e re e qytetit. Përfaqësuesit komunalë theksojnë përkushtimin e tyre të vazhdueshëm drejt përmirësimit të gjendjes në planifikimin urban, me hartimin e planit zhvillimor urban për Mitrovicën.

Burimi: Lajm ekskluzive, 11/10/06

GJILAN

Zanatet e vjetra përjashtohen nga tatimet komunale

Komuna e Gjilanit ka përjashtuar zanatet e rralla nga tatimet komunale. Duke bërë këtë, përfaqësuesit komunalë shpresojnë të kontribuojnë për zhvillimin e turizmit.

Burimi: www.gjilani-komuna.org

PEJA

Dy autobusë të ndërmarrjes Publike "Kosovatrans" u vënë në qark testues

Ky artikull jep vështrime të rëndësishme mbi transportin publik në Pejë. Linja e autobusit urban u vë në qarkullim për një javë, si pilot-veprim, qëllimi i të cilit jo vetëm që ishte mbulimi i nevojave themelore të qytetarëve të Pejës në lidhje me transportin publik dhe zvogëlimin e frekuencës së veturave brenda qytetit, por për të parën herë, themeloi transportin publik urban në qytet.

Burimi: Express, 06/09/06, pg.11

Sublimohen vërejtjet e debatit publik

Ky artikull ofron informata të dobishme mbi procesin e planifikimit në Pejë. Duke marrë parasysh rëndësinë e zhvillimit social, ekonomik dhe urban të qytetit të Pejës, Drejtorati për Planifikim dhe Zhvillim Urban, Rural dhe Mjedisor në Pejë, organizoi një punëtori dy-ditore. Punëtorja kishte për qëllim shqyrtimin e vërejtjeve dhe propozimeve të mbledhura gjatë debatit publik mbi projektet përfundimtare të Planit Zhvillimor dhe komunal, të cilat duhen integruar brenda Planit.

Burimi: Kosova Sot, 02/11/06, pg. 10

Hartat e ESPON-it mbulojnë rajonin e Ballkanit Perëndimor

Një aktivitet i veçantë ndër-shtetëror, financuar nga ESPON -i, ka kompletuar një numër hartash të ESPON-it për zonën e Ballkanit Perëndimor. Deri më tani, Shqipëria, Serbia e Mali i Zi, Kroacia, IRJ e Maqedonisë dhe Bosnja e Hercegovina shpesh konsideroheshin si "gropë e bardhë", pasi që sipërfaqja nuk mbulohej me hapësirën ESPON. Në bazë të mbledhjes dhe harmonizimeve të të dhënave shtesë, raporti paraqet për herë të parë hartat e ESPON-it me gjithë Rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Burimi: http://www.espon.eu/mmp/online/ëebbsite/content/netëork/92/469/1035/index_EN.html

RRJETËZIMI

KOSOVA BALLAFAQOHET ME SHUMË SFIDA, POR ËSHTË E VENDOSUR TË NDJEKË PRAKTIKAT MË TË MIRA TË QEVERISJES SË MIRË

Vazhdon

Seanca e përkushtuar ndaj parimeve të qeverisjes së mirë në lidhje me proceset e planifikimit hapësinor e urban nxiti debatin mbi zhvillimin e ardhshëm të zonave urbane e rurale. "Përvoja kosovare në lidhje me planifikimin strategjik përforcohet me parimet e njohura globalisht të qeverisjes së mirë, ashtu të adoptuara nga UN-HABITAT-i, gjë që ka çuar në rishqyrtimin e praktikave të planifikimit, pasi metodat e vjetra të planifikimit janë vërtetuar të jenë të papërgjegjshme ndaj nevojave të qytetarëve", tha Paul Taylor, drejtori i Zyrës Ndërlidhëse të UN-HABITAT-it për Evropën dhe Belgjikën, në referimin e tij ndaj punës së UN-HABITAT-it në Kosovë.

Qytetet e Kosovës ballafaqohen me shumë sfida: migrimi i popullsisë drejt qyteteve, vendbanimet joformale që po ndërtohen përkrah qyteteve, mungesa e infrastrukturës, mungesa e instrumenteve financiare për zhvillimin e banimit social dhe të arritshëm, proceset e ngadalshme administrative, administratat me paga të ulta e



mungesë kuadrosh, si dhe mungesa e planeve komunale e urbane.

Si të ekuilibrohen zhvillimet urbane me ato rurale? Si të shfrytëzohen më së miri resurset e kufizuara natyrore dhe hapësinore të Kosovës? Si të përgjigjemi ndaj nevojave të të rinjve, të varfërve, grave, grupeve etnike dhe të ndjeshme, dhe si komunat mund të ngrisin të ardhurat e tyre nëse ekonomia nuk mund të ngritet për shkak të

mungesës së investimeve? Këto pyetje nxitën diskutime të gjalla, por jo gjithmonë duke marrë përgjigje të qarta e pa ekuivok.

Konferenca hapi një debat me bazë të gjerë, si dhe ofroi mundësinë e paraqitjes së praktikave nga vendet tjera. Se si do të shfrytëzohen këto praktika varet shumë nga aftësia dhe përkushtimi i politikanëve, shërbyesve civilë dhe qytetarëve. Një konferencë e ngjashme planifikohet vitin e ardhshëm.

TRYEZA E RRUMBULLAKËT MBI PËRFSHIRJEN E SHOQËRISË CIVILE NË PROCESIN E PLANIFIKIMIT

UN-HABITAT-i në Kosovë mbajti punëtorinë me tryezë të rrumbullakët në Prishtinë më 14 shtator 2006. Tryeza hapi diskutime interesante në lidhje me përfshirjen e shoqërisë civile në proceset e planifikimit. Pati pjesëmarrje nga zyrtarë të ndryshëm qeveritarë e komunalë, organizatat e shoqërisë civile, ndërsa diskutimet ishin interaktive. Pjesëmarrësit theksuan që ende ka mungesë të vetëdijes në lidhje me përfshirjen e shoqërisë civile në proceset e planifikimit. Debatet, tryezat dhe punëtoritë e vizioneve mund të përdoren si vegla për rritjen dhe përmirësimin

e pjesëmarrjes së këtyre faktorëve në procesin e planifikimit. Informimi përmes mediave dhe, me më rëndësi, komunikimi direkt me qytetarë (sidomos të varfërit dhe ata me paaftësi) është thelbësor për sigurimin e pjesëmarrjes efektive. Konkludimet e nxjerra nga ky takim përfshinin: Qeveria lokale në ndihmë të "Fuqizimit të Qytetarëve" duke u përqendruar në nivelin komunitar dhe të lagjes, në identifikimin e problemeve dhe prioriteteve; Pjesëmarrësit u pajtuan të synojnë përfshirjen e vërtetë të publikut, e jo vetëm në konsultimet publike; e rëndësishme për të arritur



këtë është kërkimi i mekanizmave për avancimin e pjesëmarrjes reale; së fundi, por jo me më pak rëndësi, u tha që planifikimi dhe buxhetimi duhet të bashkërendohen, ashtu që të kemi plane të zbatueshme.

PËRSHTYPJET NGA KONGRESI I 42-TË I PLANIFIKIMIT ISOCARP NË STAMBOLL

ISOCARP është asociacion botëror i planerëve me përvojë. Themeluar më 1965, ISOCARP është organizatë jo-qeveritare, e pranuar nga Kombet e Bashkuara dhe Këshilli i Evropës, si dhe ka status konsultimi brenda UNESCO-s. Kongresi i 42 të i IsoCaRP-itë në Stamboll hulumtoi sfidat bashkëkohore dhe mundësitë në lindje, të cilat qytetet i përballojnë përkundër forcave që mund të përmbliken si integrative dhe disintegrative. Konferenca u mbajt mes 14 dhe 18 Shtator, në Universitetin Teknik Yıldız në Stamboll. UN-HABITAT-i në Kosovë mori pjesë me një delegacion prej dy planerësh nga Komuna e Mitrovicës (Fejzullah Haxhani dhe Xhemshir Mulliqi) si dhe Koordinatori i Planifikimit Hapësinor në ekipin e MuSPP-it (Frank D'hondt). Xhemshiri prezantoi një dokument mbi "Integrimin e Qytetit të Mitrovicës", ndërsa Franku paraqiti dokumentin e "Rikrijimit të Qyteteve në Kosovë". Të dy dokumentet u çmuan lart dhe janë vënë në dispozicion në internet (<http://www.isocarp.net/>). Aty mund të gjenden edhe dokumentet tjera, disa prej të cilave janë shumë interesante për praktikën e planifikimit në Kosovë, për tani dhe të ardhmen. Konferenca gjithashtu ishte mundësi e shkëlqyeshme e hulumtimit të nevojës, si dhe sukseseve të planifikimit në Stamboll. Me një popullsi të vlerësuar



prej 13 milionësh, Stambolli është metropol me rritje të shpejtë, urë mes Evropës e Azisë. Marrëdhënia e tij e ngushtë me kulturën evropiane dhe pozita e tij në udhëkryqet e shumë civilizimeve lindore, ka ndihmuar Stambollin në themelimin e statusit të tij kulturor si kryeqytet i së paku tri civilizimeve. Konferenca e qartësoi që Stambolli ka nevojë për më shumë planifikim, si dhe planifikim të mirë, për zhvillimin e metropolit të Stambollit në mënyrë më të qëndrueshme. Kongresi i 43-të ISOCARP do të mbahet në Antverp/Belgjikë vitin e ardhshëm në Shtator. Tema do të jetë "Triologjet Urbane, mënyrat ko-produktive të ndërlikjes së vizioneve me projektet

strategjike urbane". Më shumë informata mund të gjenden në <http://www.isocarp.org/>.

Shpresohet që një ditë Kosova të mund të jetë nikoqire e një Kongresi të tillë Ndërkombëtar të Planifikimit. Është vërtetuar të jetë mënyrë e shkëlqyeshme e ngritjes së vetëdijes mbi zhvillimin e qëndrueshëm urban tek të gjithë palët e përfshira dhe qytetarët në përgjithësi. Një gjë e tillë do të shtynte edhe planerët kosovarë që të dalin me ide kreative për urbanizim të qëndrueshëm në Kosovë e jashtë saj.

Duke iu falënderuar Xhemshir Mulliqit, Planer Urban, Shef i Sektorit të Planifikimit në Komunën e Mitrovicës

PUNËTORIA E CO-PLAN-IT DHE VIZITA STUDIMORE NË SHQIPËRI

Punëtorja Rajonale e Shkëmbimit (Praktikat e Qeverisjes së mirë Pjesëmarrëse" u mbajt prej 2 deri më 5 tetor në Durrës, Shqipëri, kombinuar me vizitë studimore në komunat e Fierit dhe Elbasanit. Organizimi u bë nga Co-PLAN-i, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, përmes fondeve të OSFA-Fondi i Shoqërisë së Hapur në Shqipërisë.

Ky organizim ishte mundësi e shkëlqyeshme për 26 pjesëmarrësit nga rajoni dhe Shqipëria, nga komuna të ndryshme, për shkëmbimin e praktikave të qeverisjes së mirë. 13 pjesëmarrës ishin nga Rusia, Republika Çeke, Serbia, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Holanda dhe Kosova, si dhe pjesëmarrës nga komunat e ndryshme të

Shqipërisë. Për Kosovën, një planer nga Peja (Ilir Çavdarbasha) dhe një planer nga Gjakova (Lulzim Haxhiu) morën pjesë të ndihmuar nga UN-HABITAT-i në Kosovë. Iliri dhe Lulëzimi morën pjesë me paraqitjet e tyre mbi proceset e planifikimit në Pejë dhe planifikimin e vendbanimit joformal të Brekocit në Gjakovë.

Debati i punëtorisë u përqendrua kryesisht në praktikën e lidhjeve me këto çështje të qeverisjes së mirë pjesëmarrëse: strategjitë zhvillimore të qyteteve, planifikimin e qytetit/rajonit, buxhetimi pjesëmarrës, strategjitë e zhvillimit ekonomik lokal si dhe legalizimi i vendbanimeve joformale. Delegatët nga Kosova vlerësuan kombinimin e vizitave në terren,

prezentimeve dhe diskutimeve në dhoma takimesh, si dhe organizimet e shoqërimit.

Gjithashtu, ata vlerësuan prezencën e Kryebashkiakëve të Elbasanit dhe Fierit, si dhe personelin e komunave gjatë punëtorisë. Planerët kosovarë paraqitën raportin e tyre mbi punëtorinë, në një takim të përbashkët të ekipit Kosovar të UN-HABITAT-it dhe Departamentit të Institutit të Planifikimit Hapësinor, më 19 tetor. Për më shumë informata mbi Co-Plan-in dhe Punëtorinë Rajonale të Shkëmbimit, kërkoni <http://egug.co-plan.org> or www.co-plan.org

Falënderimet i shkojnë Oriana Arapit, Co-PLAN

Edicioni i ardhshëm

- Punëtorja për Përmisimin Urban dhe Rregullarizimin e Vendbanimeve Joformale në Kosovë
- Vizita studimore në Slloveni dhe Suedi
- Takimi i 4-të Regjional mbi Vendbanimet Joformale (Beograd)

BASHKË BËJMË QYTETE MË TË MIRA

Për të siguruar një jetë më të mirë për gjithë qytetarët, Kosova ka nevojë për qytete më të mira. Kjo mund të arrihet vetëm përmes planifikimit dhe punës së përbashkët. "Bashkë krijojmë qytete më të mira" është motoja e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal, financuar nga SIDA, përmes të cilit UN-HABITAT-i do të mbështesë planifikimin komunal hapësinor në Kosovë. Planet duhet të jenë strategjike dhe të orientuara në veprime, detaje në planet rregullative urbane dhe të zbatuara me investime private e publike. Gjashtë qytetet sekondare të Kosovës – Peja, Gjakova, Prizreni, Mitrovica, Ferizaj dhe Gjilani – mund të kontribuojnë në një zhvillim më të drejtpeshuar të Kosovës dhe të zvogëlojnë migrimet e vazhdueshme të popullsisë drejt kryeqytetit, Prishtinës. Përmes integritit në rrjetin urban evropian, qytetet dhe qytetarët e Kosovës do të lidhen me qytete tjera evropiane. Kjo mund të arrihet duke tërhequr investimet në zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe duke përmirësuar qasjen për të gjithë. Investimet private janë të nevojshme për t'u kombinuar me ato publike, drejt sigurimit të shërbimeve më të mira për qytetarët: banim të përshtatshëm social, spitale, shkolla, transport publik, rrugë, si dhe përfundimisht, por jo më pak e rëndësishme, hapësirat atraktive publike për t'i kënaqur nevojat e një shoqërie në ndryshim.

IMPRESSUM



Bashkë bëjmë qytete më të mira

Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë

Zyrtari përgjegjës
Krystyna Galezia
galezia@un.org

Zyra:
UN-HABITAT Kosovë
Rruga Nazim Gafurri,
nr.33, 10000
Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381/38/517835
Fax: +381/38/517836

Informimi dhe komunikimi/
Marrëdhëniet Publike
Lumnije Gashi
lumnijegashi8@gmail.com

Më shumë informata mbi
UN-HABITAT-in:
www.unhabitat.org

Ky Buletin është mundësuar nga Qeveria e Suedisë përmes SIDA-s. Gjitha vështrimet, mendimet dhe konkludimet i përkasin autorëve. Artikujt pa tregim autori janë pjesë e ekipit të MuSPP-it. Kontributet në lidhje me komunat jo domosdoshmërisht reflektojnë pozitën dhe vendimet e komunave në fjalë. Përmbajtja e këtyre artikujve jo domosdoshmërisht reflektojnë: Qëndrimin e UN-HABITAT-it ndaj çështjeve të ngritura apo deklaratave të bëra, si dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë vështrimet e SIDA-s, apo Qeverisë së Suedisë.